



Fondo Europeo per l'Integrazione dei cittadini di Paesi Terzi 2007/2013  
Programma annuale 2009 - Azione 5  
Prog. n. 2009/FEI/3969

## **REGJISTRIM VULLNETAR NE SHERBIMIN SHENDETESOR NACIONAL PER QYTETARET E HUAJ NE MOSHE MBI 65 VJEC TE ARDHUR NE ITALI ME BASHKIM FAMILJAR**

Tani eshte bere i mundur regjistrimi ne Sherbimin Shendetesor Nacional per qytetaret ekstrakomunitare , ne moshe mbi 65 vjec, qe kane hyre ne Itali me bashkim familjar , kerkesa per te cilin eshte bere pas dates 5 nentor 2008.

Ne fakt, ne pritje te dekretit te parashikuar nga Ministria, Regione Emilia-Romagna – Drejtoria e pergjithshme e Shendetit dhe Politikave Sociale, me nje note te posacme me prot.n.188856, parashikon per keta qytetare mundesine e regjistrimit vullnetar ne Sherbimin Shendetesor Nacional. Ky regjistrim behet duke paguar nje kontribut vjetor prej 387,34 Euro me perjashtim te nje eventuale shtese qe mund te behet nga ana e Ministrise.

Per regjistrimin vullnetar ne Sherbimin Shendetesor Nazional, qytetari i huaj ne moshe mbi 65 vjec duhet te prezantoje ne sportelet e Ausl dokumentat e meposhtme:


- pashaporte me vize- hyrje per bashkim familjar
- nulla osta per bashkim familjar te leshuar nga Sportello Unico per l'Immigrazione ne Prefektore ose, ne qofte se e keni, lejeqendrimin (Permesso di Soggiorno)
- mandat pagesen prej 387,34 Euro te bere ne llogarine postale n. 569400 intestuar Amministrazione P.T.C.S.S.N. Regione Emilia-Romagna
- certifikate ose autocertifikate mbi te ardhurat familjare

Regjistrimi vullnetar ne SSN per vitin ne vijim eshte i vlefshem deri ne 31 dhjetor 2010, dhe mund te rinovohet cdo vit kundrejt pageses 387,34 Euro.

Ju kujtojme gjithashtu se qytetaret te cilet kane bere kerkesen per bashkim familjar para dates 5 nentor 2008 dhe kane marre Permesso di Soggiorno, ne momentin e mbushjes se moshes 65 vjec, dhe ne rast rinovimi te dokumentave, do te vazhdojne te regjistroheshen falas ne Sistemin Shendetesor Nacional.

Per informacione te metejshme dhe per regjistrim ne SSN mund ti drejtoheni sporteleve te Ausl ne Ravenna.

Pervec sporteleve te Ausl te Ravenes mund te merni informacion duke kontaktuar operatoret e ekipit FEI ne numrin e telefonit: 338 2483414



**SERVIZIO SANITARIO REGIONALE  
EMILIA-ROMAGNA**  
Azienda Unità Sanitaria Locale di Ravenna

